REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 35/17
Datë/Datum. 03.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 35/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE **"Graniti"shpk** – Suharekë, kundër Autoriteti Kontraktues - **Ministria e Administratës Publike -MAP**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me inventar për nevojat e MAP-it, me nr.prokurimit: 202-16-115-121**. Kryetari i Panelit konform nenit **28** par **1**, të rregullores së punës së OSHP-së, nr. **02/2015**, me dt. **01.03.2017**, nxori këtë:

V E N D I M

I. <u>Aprovohet,</u> ankesa e OE **"Graniti"shpk** – Suharekë, me nr. **35/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me inventar për nevojat e MAP-it, me nr.prokurimit: 202-16-115-12**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **Ministria e Administratës Publike -MAP,** si e bazuar.

II. <u>Anulohet,</u> vendimi i Autoritetit Kontraktues / **Ministria e Administratës Publike - MAP**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit: **"Furnizim me inventar për nevojat e MAP-it, me nr.prokurimit: 202-16-115-12**, si i pa bazuar.

III. <u>Obligohet</u>, Autoriteti kontraktues / **Ministria e Administratës Publike -MAP**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit: **"Furnizim me inventar për nevojat e MAP-it, me nr.prokurimit: 202-16-115-12,** ta kthej në **RIVLERESIM** dhe në afat prej 10 ditësh ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit..

IV. Operatorit ekonomik ankues ekonomik **"Graniti"shpk** – Suharekë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, pasi që pretendimet ankimore janë të bazuara, megjithatë i njejti OE obligohet që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik: **"Graniti"shpk** – Suharekë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më **02.02.2017** me nr. **35/17**, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: **"Furnizim me inventar për nevojat e MAP-it, me nr.prokurimit: 202-16-115-12,** duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, me Ligjin 05/ L-092, siç janë: Nenit 1, 6, 7 dhe 62, të LPP-së, si dhe nenit 44.7, të UOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin shqyrtues me datën **07.02.2017**, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë, i njejti ekspert më datën **13.02.2017**, ka dorëzuar raportin e ekspertizës duke i rekomanduar panelit shqyrtues që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndersa vendimi i AK- MAP, njoftimi për anulim të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Kryetari i Panelit konform nenit 28 par 1, të rregullorës së punës së OSHP-së nr. 02/2015, vendosi që seanca të mbahet pa prezencen e palëve, ku në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 01.03.2017, ishin prezent kryetari i Panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues i cili arsyetoj rekomandimin e tijë të dhënë në raport të ëkspertizës.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të parashtruesit të ankesës konstaton se pretendimet ankimore të perfshira në ankesën e OE "Graniti"shpk, nga Suharekë, janë të bazuara, pasi që AK – MAP, në kundërshtim me nein 44.22, të rregullave të udhëzuesit operativ për prokurim publik, legjislacion sekondar i nxjerrur nga KRPP, ka anuluar aktivitetin e prokurimit, pa e bërë vleresimin e ofertes së dorëzuar nga parashtruesi i ankesës për kundër faktit që AK-MAP, ka formuar komisionin e vleresimit të ofertave rrjedhimishte AK – MAP, me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit në këtë fazë dhe me arsyetim të tillë nuk ka respektuar nenin 62, par 2, nënparagrafi 2.2, të LPP-së.

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë, por për
kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, me kërkesë
-padi mund ti drejtohet.
Departamentit
përçështjeAdministrative,
në Gjykatën themelore në Prishtinë.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1ekzemplar – OE – "Graniti"shpk – Suharekë.
1x1 ekzemplar - AK "Ministria e Administratës Publike",
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së.